

Anulimi i mbajtjes së seancës konstituive të 12 shtatorit me kërkesë të Listës Serbe, duket të jetë vetëm fillimi i problemeve që pritet të shkaktojë inkuadrimi i saj në institucionet shtetërore.

Fakti që seanca e thirrur nga kryesuesja Flora Brovina për t’u mbajtur të premtën më 12 shtator u anulua pas kërkesës së Listës Serbe, tregon për forcën që ka ky grup politik në Kosovë, vlerësojnë njohësit e rrethanave politike në vend.

Lidershipi kosovar, sipas tyre, do të duhej të bëhej më unik në mënyrë që vendi të dalë nga ky ngërç politik që ka kapluar vendin tash e tre muaj.

Për Afrim Hotin, fakti që kjo listë po e përcakton agjendën e krijimit të institucione paraqet një shqetësim të madh për situatën politike në vend.

“Është jashtëzakonisht shqetësuese që një grup relativisht i vogël i deputetëve, prej fuqisë parlamentare tashmë përcaktojnë edhe agjendë”, ka thënë Hoti.

Kjo situatë e krijuar, sipas tij, do të duhej të shërbente si një sinjal për lidershipin e Kosovës.
/Tribuna/